

VENDIM
Nr. 586, datë 18.10.2017

PËR MIRATIMIN E NDRYSHIMIT
TË MARRËVESHJES SË FINANCIMIT, NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË
REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË, TË PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E FINANCIVE
DHE EKONOMISË, DHE BANKËS EVROPIANE TË INVESTIMEVE,
PËR ASISTENCËN TEKNIKE
PËR PROJEKTIN E RRUGËVE DYTËSORE DHE LOKALE NR. 2 – MBËSHTETJE PËR
ZBATIMIN
DHE QËNDRUESHMËRINË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 19 e 23, të ligjit nr. 43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, me propozim të ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e ndryshimit të marrëveshjes së financimit, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, dhe Bankës Evropiane të Investimeve, për asistencën teknike për projektin e rrugëve dytësore dhe lokale nr. 2 – mbështetje për zbatimin dhe qëndrueshmërinë, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Senida Mesi

Dërguar me DHL

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë
Ministria e Financave
Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, nr. 4.
Tiranë, Shqipëri

Në vëmendje të z. Arben Ahmetaj, ministër i Financave

Luksemburg, 28 shkurt 2017 JU/OPS/SEE/BC/md n.

Lënda: Marrëveshje financimi për asistencën teknike për projektin e rrugëve dytësore dhe lokale nr. 2 – Mbështetje për zbatimin dhe qëndrueshmërinë, e lidhur nga dhe ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Evropiane të Investimeve, më 4 shtator 2013, më pas e ndryshuar (**Marrëveshje Financimi**)
Amendimi i Marrëveshjes së Financimit

Të nderuar zotërinj,

Shkresa i referohet:

i) Marrëveshjes së Financimit të përcaktuar më lart;

ii) Shkresës suaj të datës 20 dhjetor 2016.

1. INTERPRETIMI

Përveç rasteve kur përcaktohet ndryshe, termit me shkronja kapitale në këtë shkresë kanë të njëjtin kuptim siç u atribuohet atyre në Marrëveshjen e Financimit. Referimet që u bëhen neneve në këtë shkresë janë referime të neneve në Marrëveshjen e Financimit.

Në këtë shkresë:

“Data e hyrjes në fuqi” nënkupton datën në të cilën Banka i konfirmon Përfituesit me shkrim (duke përfshirë me postë elektronike apo mjete të tjera elektronike) se Banka ka marrë në formë dhe përmbajtje të pranueshme për të, dy (2) kopje origjinale të kësaj shkrese të bashkënenshkruara sipas rregullave në emër të Përfituesit, së bashku me një kopje të vërtetuar të autoritetit përkatës të nënshkruesve, përveç rasteve kur parashikohet ndryshe.

2. AMENDIME TË MARRËVESHJES SË FINANCIMIT

Me hyrjen në fuqi në datën e hyrjes në fuqi, Marrëveshja e Financimit ndryshohet siç përcaktohet më poshtë:

Neni 1.02

Paragrafi i dytë në nenin 1.01 ndryshohet dhe formulohet si në vijim:

*“Banka do të kryejë disbursimin e grantit deri në 5 transhe (secili do të jetë një **“Transh”**). Shuma e Transhit të parë do të jetë 400,000 euro. Shuma e secilit Transh pasues, me përjashtim të dy transheve të fundit, do të jetë minimumi 200,000 euro. Përfituesi, mund t’i paraqesë herë pas here Bankës, nëpërmjet ADF-së, deri më 31 dhjetor 2017 apo ndonjë datë tjetër të miratuar nga Banka, një kërkesë për disbursim (**Kërkesë disbursimi**), kryesisht në formën e bashkëlidhur kësaj shkrese si skeduli B”.*

Ndryshime të skedulit A – Përshkrimi teknik

Paragrafi 4 në skedulit A ndryshohet dhe formulohet si në vijim:

“4. Data e përfundimit për përdorimin e grantit është 31 dhjetor 2017.”

3. VAZHDIMI I DETYRIMEVE

Dispozitat e Marrëveshjes së Financimit, përveç rasteve kur ndryshohen sipas kësaj shkrese, mbeten në fuqi dhe efekt të plotë. Përfituesi pranon dhe bie dakord se, përveç siç është përcaktuar dhe rënë dakord përmes kësaj shkrese, kjo shkresë nuk përbën heqjen dorë të miratuar nga Banka apo ndryshim të ndonjë kushti tjetër të Marrëveshjes së Financimit. Banka rezervon të gjitha të drejtat kontraktuale dhe ligjore që ka sipas Marrëveshjes së Financimit dhe ligjit në fuqi.

Përfituesi do të kryejë, me kërkesën e Bankës dhe shpenzimet e veta, të gjitha veprimet dhe hapat e nevojshëm apo të dëshirueshëm për t’i dhënë fuqi ligjore ndryshimeve të kryera ose që do të kryhen sipas kësaj shkrese.

4. LIGJI RREGULLUES DHE JURIDIK-SIONI

Kjo shkresë rregullohet sipas ligjeve të Dukatit të Madh të Luksemburgut dhe palët e përfshira janë subjekt i juridiksionit të Tribunal d’Arrondissement (Gjykatës së Rrethit) të Luksemburgut.

Nëse pajtoheni me sa më lart, ju lutemi dërgoni dy (2) kopje origjinale të kësaj shkrese për Bankën, në vëmendje të z. Branko Cevriz (tel: +352 4379 82545, email: b.cevriz@eib.org), të nënshkruara në çdo faqe, me datë dhe të nënshkruara në emër të Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë,

përfaqësuar nga ministri i Financave në cilësinë e Përfituesit sipas Marrëveshjes së Financimit, së bashku me një kopje të vërtetuar të autoritetit përkatës të nënshkruesve, përveç rasteve kur parashikohet ndryshe, *jo më vonë se data 15 prill 2017*. Pas kësaj date, Banka rezervon të drejtën, me diskrecionin e saj, nëpërmjet një njoftimi drejtuar Përfituesit, që të konfirmojë nëse pranimi i kësaj shkrese nga Përfituesi konsiderohet i dhënë në mënyrë të vlefshme nga Përfituesi.

Me respekt,
BANKA EVROPIANE E INVESTIMEVE

Massimo Novo	Jean-Marc Arnoux
(Nënshkrimi)	(Nënshkrimi)

Pranuar dhe rënë dakord për dhe në emër të:

Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë

Përfaqësuar nga ministri i Financave,
si Përfituesi

Z. Arben Ahmetaj, ministër i Financave

Datë 13 prill 2017